Versioni 1
Mars 2021

# Vendndodhja e Sportistit

Në shikim të parë

ADEL BY WADA

# Çfarë kuptojm me Vendndodhjen?

Vendndodhja është informacioni i dhënë nga disa sportistë, në atë mënyrë që organizatat e Anti-Doping (ADO) të mund t'i lokalizojnë sportistët për testim, veçanërisht në testim jashtë garave.

Informacioni i vendndodhjes duhet të jetë i saktë dhe i përditësuar në çdo kohë ose mund të ketë pasoja.

*Testimi është një pjesë e rëndësishme e programit të anti-doping dhe zakonisht zhvillohet pa njoftim paraprak për sportistin.*

# Cilët sportistë?

Sportistët që duhet të japin informacion mbi vendndodhjen janë zakonisht pjesë e **Lista e Regjistruar për Testim (RTP).**

Sportistët RTP janë zakonisht sportistët me prioritet më të lartë për një ADO. Kjo mund të përfshijë; sportistët olimpikë ose paralimpikë, sportistët të renditur në nivele të lartë në sportet e tyre, sportistët që garojnë në sport me prioritet të lartë kombëtar ose ata që garojnë rregullisht në nivelin më të lartë të garave ndërkombëtare, siç janë kampionatet botërore.

Në disa raste edhe sportistëve të tjerë u kërkohet të japin informacion mbi vendndodhjen. Për shembull, sportistët që marrin pjesë në garat kryesore ose sportistët të përfshirë në Listën e Regjistruar për Testim të brendshëm ose të ndonjë ADO tjetër.

*Federatat Ndërkombëtare dhe Organizatat Kombëtare Anti-Dopingut janë përgjegjëse për të përcaktuar sportistët që duhet të japin informacion mbi vendndodhjen. Organizatorët e ngjarjeve të mëdha, siç është Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), mund të kenë kërkesa specifike për vendndodhjen gjatë kohës së lojërave për sportistët pjesëmarrës.*

**E rëndësishme:** Sportistët duhet të mbajnë informacionin e Vendndodhjes së tyre të përditësuar në çdo kohë. Nëse planet e tyre ose plani ndryshon për ndonjë arsye, ata janë përgjegjës për përditësimin e informacionit të vendndodhjes së tyre. Mosbërja e kësaj mund të çojë në pasoja.

# Çfarë informacioni?

Sportistët e RTP-së të cilëve u kërkohet të japin informacione mbi vendndodhjen e tyre tek ADO-ja, duhet të përfshijnë:

- Adresa e shtëpisë, email adresa dhe numri i telefonit
- Një adresë akomodimi gjatë natës
- Aktivitete të rregullta, të tilla si ushtrimet, puna, shkolla ose Universiteti dhe Vendndodhjet e tyre, gjithashtu edhe sa herë do të jenë atje
- Oraret e garave duke përfshirë ku dhe kur zhvillohen ato
- Një kohë 60-minutëshe për çdo ditë ku do të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme për testim

*Sportistët që nuk janë pjesë e grupit RTP-së, por të cilëve u kërkohet të japin informacionin e Vendndodhjes, mund të kenë kërkesa të ndryshme.*

*Dhe mbani mend, sportistët mund të testohen në çdo kohë dhe kudo - jo vetëm në kohën e tyre 60-minutëshe!*

# Dorëzimi dhe përditësimi i Vendndodhjes

Informacioni i vendndodhjes duhet të jetë i përditësuar dhe i saktë në çdo kohë!

- Shumica e sportistëve të RTP plotësojnë informacionin e Vendndodhjes së tyre nëpërmjet Sistemit të Administrimit Anti-Doping të WADA-së (ADAMS).
- Aplikacioni për telefonat e mençur, 'Athlete Central' është i disponoheshim për sportistët, për te plotësuar dhe përditësuar informacionin mbi Vendndodhjet e tyre.
- Sportistët RTP duhet të dorëzojnë informacionin e Vendndodhjes së tyre në një datë dhe orë specifike për 3 muajt e ardhshëm (tremujori i ardhshëm). Ora dhe data caktohen nga ADO-të.
- Nëse planet ndryshojnë, atëherë informacioni i Vendndodhjes duhet të përditësohet. Mënyra më e lehtë për ta bërë këtë është nëpërmjet **Athlete Central**, ADAMS ose me SMS nëse kjo është e aktivizuar në ADAMS. Ndonjëherë ADO-të lejojnë përditësime edhe me email.
- Mund të ketë pasoja nëse një sportist nuk është aty ku thotë se është dhe nuk mund të gjendet për testim. Kjo njihet si një testim i humbur.
- Mund të ketë pasoja nëse një sportist nuk paraqet në kohë informacionin e Vendndodhjes së tij ose jep informacion të pasaktë. Kjo njihet si një dështim në paraqitjen e të dhënave.
- Çdo kombinim i 3 dështimeve në paraqitjen e të dhënave ose teste të humbura në një periudhë 12-mujore mund të çojë në një shkelje të Rregullave të Anti Doping (ADRV).



ADAMS

***Çfarë është ADAMS?***

*Sistemi i Administrimit dhe Menaxhimit Anti-Doping i WADA-s (ADAMS), është një mjet në internet që sportistët mund t'i qasen në çdo kohë dhe kudo për të paraqitur dhe përditësuar informacionin mbi vendndodhjen e tyre.*
*ADAMS është në dispozicion në shumë gjuhë.*
*ADAMS është falas, i lehtë për t'u përdorur dhe merr seriozisht privatësinë dhe sigurinë e informacionit të sportistit.*

# Mos harro!

Informacioni mbi vendndodhjen është një pjesë thelbësore e çdo programi testimi që ndihmon në mbrojtjen e sportit të pastër.

- Sportistët janë përgjegjës për informacionin e vendndodhjes së tyre.
- Sportistët nuk mund të fajësojnë përfaqësuesin ose agjentin e tyre për regjistrimin e gabuar ose harrimin e përditësimit të informacionit të tyre mbi vendndodhjen.
- Sportistët e përfshirë në një RTP, duhet të japin informacionin e vendndodhjes çdo 3 muaj në mënyrë që ata të mund të lokalizohen për testim.
- Sportistët e përfshirë në një RTP, duhet të mbajnë mend, mund të ketë pasoja nëse nuk japin informacion të saktë mbi vendndodhjen e tyre.
- Tre dështimet e vendndodhjes në 12 muaj është një nga 11 Shkeljet e Rregullave Anti-Doping për të cilat sportistët mund të sanksionohen.

WADA

WADA's regulatory documents are available on the Agency's website. The material that WADA provides on its ADEL platform is intended for educational and informational purposes only. Any content or language used within the ADEL material would not supersede the provisions of the World Anti-Doping Code and/or the International Standards.

ADEL and its education courses and information resources are managed by WADA and published by WADA in English as a minimum.

In any case of any discrepancies between the English version or any version sponsored by an Anti-Doping Organization, the English version shall prevail.

wada-ama.org
info@wada-ama.org
facebook.com/wada.ama
twitter.com/wada_ama

**HEADQUARTERS**
800 Place Victoria, Suite 1700, P.O. Box 120, Montreal, QC, H4Z 1B7, Canada • Tel.: +1.514.904.9232 • Fax: +1.514.904.8650

**AFRICA**
Protea Assurance Building, 8th Floor, Greenmarket Square, Cape Town, 8001, South Africa • Tel.: +27.21.483.9790 • Fax: +27.21.483.9791

**ASIA/OCEANIA**
C/O Japan Institute of Sports Sciences, 3-15-1 Nishigaoka, Kita-Ku, Tokyo, 115-0056, Japan • Tel.: +81.3.5963.4321 • Fax: +81.3.5963.4320

**EUROPE**
Maison du Sport International, Avenue de Rhodanie 54, 1007 Lausanne, Switzerland • Tel.: +41.21.343.43.40 • Fax: +41.21.343.43.41

**LATIN AMERICA**
World Trade Center Montevideo, Tower II, Unit 712, Calle Luis A De Herrera 1248, Montevideo, Uruguay • Tel.: +598.2.623.5206 • Fax: +598.2.623.5207